



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



KUVENDI I KOMUNËS
KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA
01. Nr. 06-3506/17
KLINË, 15.5.2017

EKSTRAKT

I PROCESVERBALIT TË SEANCËS SË V-te, TË KPF, MBAJTUR MË 15.5.2017, NË ORËN
10, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryesuesit i KK, Dr. Haxhi Ibishi, anëtarët e KPF-së, Zyra ligjore etj.

Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesi, Dr. haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe iu uroj mirëseardhje në këtë mbledhje të KPF-së. "Materialin e keni marrë me kohë, hapi debatin rrëth procesverbalit të seancës së kaluar", tha kryesuesi.

Nuk pati debate rrëth procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

Me vota unanime u miratua ky

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar - mars 2017,
4. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës rimore në Klinë, ngastra nr. 587/ZK Klinë (i miratuar më 30.3.2017), sipas kërkesës së MMPH, të datës 2.5.2017),
5. Shqyrtimi i kërkesave të arritur në KPF për muajin prill 2017,
6. Të ndryshme.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi se nuk ka mungesa nga ana e anëtarëve të KPF-së.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi hapi debatin rreth pikës së dytë të rendit të ditës.

Nuk pati debate rreth pikës, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

Me vota unanimë u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika e tretë: Shqyrtimi i Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar - mars 2017.

Kryesuesi fjalën për raportim e barti te drejtori i Drejtorisë për FEZH, z. Ramiz Rrusta.

Ramiz Rrusta, drejtor i Drejtorisë për FEZH, raporti rreth raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar – mars 2017.

“Kemi nxjerrë shpenzimet për secilën drejtori. Do të japim pasqyrën e shpenzimeve për periudhën tremujor janar-mars 2017. Për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën janar – mars 2017 do të japim një pasqyrë të buxhetit , të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore , do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak . Për këtë periudhë buxheti total ka qenë në vlerën pre 8,721,687.33 euro. Buxheti i shpenzuar në periudhën janar –mars 2017 në vlerë 1,660,060.40 € është 19.03 % e buxhetit në SIMFK në periudhën janar- mars 2017. Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 1,629,035.20 € (21.39 % në rapport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat vetanake 28,244.59 € (2.74 % në rapport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat për 2017) dhe nga donacioni i Save the Children janë shpenzuar 2,780.61 € (100% në rapport me buxhetin nga donacioni). Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 1,660,060.40 € nga Granti qeveritar janë shpenzuar 98.13 % , nga të hyrat e vitit 2017 është shpenzuar 1.70 % dhe nga Save the Children 0.17 %. Nga buxheti i shpenzuar në përudhen janar – mars 2017 në vlerë 1,660,060.40,€ për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,413,244.37 € (85.13% e shpenzimeve), përmallra dhe shërbime janë shpenzuar 133,836.38 € (8.06% e shpenzimeve), për shërbime komunale 51,000.92 € (3.07 % e shpenzimeve), për subvencione 2,568.40 € (0.16 % e shpenzimeve) dhe përkapitale 59,410.33 € (3.58 % e shpenzimeve). Shpenzimet në periudhën janar-mars 2017 në vlerë 1,660,060.40 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2016 në vlerë 1,891,214.78 € janë zvogëluar për rreth 12.22 % . Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë zvogëluar 0.06 % , shpenzimet përmallra dhe shërbime janë zvogëluar për 14.11 %, shpenzimet për shërbime komunale janë rritur për 13.42 % , shpenzimet për subvencione janë rritur për 633.83 % dhe shpenzimet përkapitale janë zvogëluar për 78.46 %. Raport i shpenzimeve për periudhën janar- mars 2017 jep këtë pasqyrë: shuma e paguar është në vlerë prej 1.660. 060.40 euro. Rreth këtij reporti do të bisedohet edhe në seancën e radhës të KK-së”, ka shtuar drejtori Rrusta.

Fadil Gashi, tha se i vetmi shqetësim është ta përmend shifrën mbi 600 për qind të subvensioneve. “Dëshirojmë pér të ditur nga janë orientuar subvencionet? Mbi 600 për qind është një shumë tepër e lartë”, pohoi anëtari Gashi.

Skënder Merturi, tha se kam një kërkesë prej drejtorit të financave, sa do të jetë në gjendje drejtori të përcjellë një menaxhim korrekt kur kemi të bëjmë me muajin e fushatës zgjedhore”.

Pal Berisha, tha se vitin e kaluar gjyqësori ka kaluar shifrën prej 100 mijë euro, a kemi lënë në gjykata dhe si do të ndahemi në këtë vit me çështjet gjyqësore.

Ramiz Rrusta, iu përgjigje interesimeve të anëtarëve. “Këtë shifër të subvencioneve e ka rritur ndarja e mjeteve pér festivalin “I këndojmë lirisë”. Do t’u sjelli në seancën e radhës të KK specifikacionet. Çdo cent pér shpenzimet do t’ju sjell. Asnjë cent nuk do të keqpërdoret, përkatësisht nuk do të shkojë pér fushatën. Nuk do të ketë mundësi ndonjë keqpërdorim pér fushatë. Do ta kemi reportin. Ne si drejtori kemi të pasqyrvara gjitha shpenzimet, e di që kemi lëndë në gjykatë, thesari ekzekuton vendimin e vet, prandaj edhe nuk na pyesin. Vlera e shpenzimeve pér festival nuk është këtu. Do t’ju vjen rapporti. Çdo gjë do të jetë transparente rrëth festivalit.

Haxhi Ibishi, tha se në seancën e radhës të KK drejtori do të prezantojë specifikacionet.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin pér rekomandim në AK.

Me vota unanime u miratua rekomandimi pér procedim në AK.

Pika e katërt: Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës pér caktimin e lokacionit pér ndërtimin e objektit të Qendrës rinore në Klinë, ngastra nr. 587/ZK Klinë (i miratuar më 30.3.2017), sipas kërkesës së MMPH, të datës 2.5.2017).

Kryesuesi Ibishi foli rrëth çështjes në shqyrtim. Fjalën e barti te zyrtari i Drejtorisë pér Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, z. Ali Gashi.

Ali Gashi, sqaroi rrëth çështjes në rendë ditës. “Është kthyer vendimi i Asamblesë komunale të datës 30.3.2017, nga MMPH. Më shumë ka defekte nga ministria gjegjëse se sa nga ju. Vendimi është kthyer pér shkak të hartimit. Jemi në dakord që të shqyrtohet. Do të bëhet përmirësimi”, sqaroi zyrtari Gashi.

Ndue Shabanaj, foli rrëth çështjes në debat: “ Ky vendim duhet të shqyrtohet. Raste të kthimit të vendimmarrjeve tona po na përsëiten disa herë. Para vendimmarrjes është dashur që Zyra ligjore dhe profesionistët paraprakisht ata të Zyrës ligjore ta shqyrtojnë. Zyra ligjore duhet paraprirë anës ligjore. Kjo nuk po ndodh, por po vetëm po sqarohet para vendimit”, theksoi prof. Shabanaj.

Fadil Gashi, tha se vendimin e kemi miratuar unanimisht. "Nuk është e sinqertë kjo që po ndodh me kthimin e këtyre vendimeve, që po na kundërshtojnë me procedurat. Numri i vendimeve që na janë kthyer janë shumë. Zyra ligjore dhe DÜ po na vënë në lajthitje. Ne nuk dimë çfarë të vendosim. Ne nuk kemi asnje material për të shqyrtuar. Me këtë kthim po tregon se kemi ekzekutivin më të padijshëm", u shpreh anëtari Gashi.

Skënder Merturi, tha se Zyra ligjore është dashur të na pasjis me dokumente mos me gabuar. "Ky kthim na tregon paaftësinë e ekzekutivit. Më së shpeshti dokumentet na janë kthyer nga Drejtoria e Urbanizmit. Shpresojmë që në të ardhmen nuk na vijnë këto kthime", pohoi anëtari Merturi.

Haxhi Ibishi, tha se mendimi im është që shteti po funksionon, po na vënë në binarë. "Ministria ka marrë një vendim profesional. Është një shkresë që e kemi shpjeguar. Duhet të korrigohemi më shumë në aspektin teknik. Nuk duhet marrë shqetësuese kthimin e vendimeve. Ligjet e caktuara po shkaktojnë shqetësimë. Materiali që na sillet të sillet i bazuar në ligj", shtoi kryesuesi Ibishi.

Pal Berisha, tha se do të shpreh mospajtueshmërinë me ju kryesues, "Nuk është problem teknik, por mungesë e aftësisë profesionale. Edhe muajin e kaluar kemi pasur kthim të vendimeve. Ju takon të ndërmerrni diçka. Për çdo seancë kemi nga një kthim të vendimeve", u shpreh anëtari Berisha.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes në debat.

Pal Berisha, tha se çështja nuk ka lidhje me zgjedhjet e 11 qershorit, thashë që ministria shpesh po gjen gabime.

Ali Gashi, tha se Drejtoria e Urbanizmit e ka iniciuar shkresën, po ta lëxojmë do t'i gjejmë qëndrimet e ministrisë. "Kemi vetëm lëshimi teknik. Zyra e Kuvendi, të përforcohet", tha ndër të tjera zyrtari Gashi.

Fadil Gashi, tha se nuk është hera e parë, por këto po ndodhin shpesh. "Merreni raportin e ministrisë e do të gjeni ku e kenj gjendjen që ka të bëj me monitorimin, e shihni ku gjendet Komuna e Klinës. Me marrë një vendim është dashur të mëret PZHU. Është dashur për t'iu nënshtruar PZHU-së. Atë është duke iu kërkuar. Keni probleme me PZHU. Keni defekte, mos thoni se s'ka shkelje ligjore. Është dashur të përfillen procedurat. Nuk duhet të ndihet mirë Kuvendi që na kthehen këto vendime. Po e deklaroj vëten për ta rekomanduar që vetëm për seancë", theksoi anëtari Gashi.

Ramush Agushi, tha pse të na sillet në KPF, kjo është e drejtë e ekzekutivit, jona jo – tha anëtari Agushi.

Pika e pestë; **Shqyrtimi i kërkesave të arriur në KPF për muajin prill 2017.**

Kërkesa e Grupeve parlamentare: LDK, AAK, VV dhe AKR-së, ku kërkojnë që në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës të sillet incizimi, po ashtu edhe transkripti i seancës së kaluar të Kuvendit (dt. 28.4.2017).

Kryesuesi informoi se procesverbalin e seancës së kaluar, përkatësisht të datës 28.5.2017, do ta kenë me materialin e Kuvendit gjithsesi, ndërsa sa i përket incizimit mund t'iua sigurohet dëgjimi.

Kryesuesi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë.

Mbledhjen e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 10:50 minuta.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI

